



**RADIO TELEVISIONI SHQIPTAR
DREJTORIA E PËRGJITHSHME**

Nr. 2053/ Prot.

Tiranë më 22.09.2025



AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Nr. 2599 Prot.

Tiranë më 21.10.2025

KONTRATË E SHËRBIMIT TË TRANSMETIMIT PUBLIK

E lidhur sot më, datë 21/10/2025, me vullnet të lirë, të plotë e të pavesuar, midis palëve:

Autoriteti i Mediave Audiovizive, me seli në Tiranë, rruga “Papa Gjon Pali II, Nr.15”, përfaqësuar nga Kryetari, **znj. Armela Krasniqi**, që më poshtë do t’i referohemi si **AMA**. dhe

Radio Televizioni Shqiptar, me seli në Tiranë, rruga “Ismail Qemali”, Nr.11, përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm i RTSH-së, **znj. Eni Vasili**, që më poshtë do t’i referohemi si **RTSH**.

Neni 1

Objekti

Objekti i kësaj kontrate është përcaktimi i parimeve dhe veprimtarive që RTSH merr përsipër të realizojë, për të përmbushur detyrimet e vendosura në ligjin nr.97, datë 04.03.2013 “Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në kuadër të realizimit të qëllimit për të cilin është krijuar dhe funksionon, si një transmetues publik në garantimin e shërbimit të nevojshëm e të përshtatshëm për publikun shqiptar.

Neni 2

Baza ligjore

Kjo kontratë hartohet bazuar në Ligjin nr.97, datë 04.03.2013 “Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 117 në veçanti, VKM nr.1187, datë 24.12.2020 “Për miratimin e planit kombëtar të frekuencave”, aktet ligjore e nënligjore në fuqi në fushën e mediave audiovizive në Republikën e Shqipërisë, si dhe akte të tjera që rregullojnë marrëdhëniet civile në Republikën e Shqipërisë.

Neni 3

Parimet

Parimet kryesore që respekton dhe mbi të cilat mbështetet RTSH gjatë veprimtarisë së saj për ofrimin e shërbimit të transmetimit audio dhe audiovizive për publikun janë:

- Parimi i garantimit të transmetimit audio dhe audioviziv.
- Parimi i ndalimit të censurës paraprake gjatë komunikimit me anë të transmetimeve audio apo transmetimeve audiovizive duke siguruar akses për të gjithë ata që duan të përfitojnë shërbime të transmetimeve audio dhe/ose audiovizive.
- Parimi i garantimit të lirisë së shprehjes dhe informimit si një nga parimet kryesore të lirisë dhe të drejtave të individit në Republikën e Shqipërisë.
- Parimi i lirisë dhe fshehtësisë së korrespondencës dhe burimeve gjatë transmetimit me mjete të komunikimeve audio dhe audiovizive.
- Parimi i ligjshmërisë gjatë realizimit të qëllimit të veprimtarisë së RTSH-së.
- Parimi i paanshmërisë dhe pavarësisë editoriale gjatë transmetimeve audio dhe transmetimeve audiovizive.
- Parimi i respektimit të paanshmërisë në bindjet politike dhe besimeve fetare të publikut.
- Parimi i respektimit të personalitetit, dinjitetit dhe jetës private të njeriut.
- Parimi i respektimit dhe i mbrojtjes të të drejtave, interesave, kërkesave morale e ligjore të të miturve.
- Parimi i moscënimit të rendit kushtetues, sovranitetit dhe integritetit kombëtar gjatë veprimtarisë audio dhe audiovizive.
- Parimi i mosdiskriminimit dhe barazisë së individëve për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, kombësia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore, aftësia e kufizuar apo antëtarësisë në sindikata.
- Parimi i respektimit të kulturës, gjuhës shqipe dhe të standartit letrar të saj.
- Parimi i respektimit të të drejtave kushtetuese të pakicave kombëtare në përputhje me konventat ndërkombëtare të nënshkruara nga Republika e Shqipërisë.
- Parimi i paraqitjes objektive dhe të paanshëm të informacionit për publikun duke respektuar formimin e lirë të opinionit të tij.
- Parimi i mos lejimit të transmetimeve që nxisin dhunën dhe intolerancën ndërmjet shtetasve.
- Parimi i të drejtës për të dhënë përgjigje për informacionet e kërkuara.
- Parimi i respektimit të fqinjësisë së mirë midis popujve.
- Parimi i garantimit të së drejtës së autorit në lidhje me shfrytëzimin ose përdorimin të një vepre audio ose audiovizive.

- Parimi i garantimit të së drejtës së transmetimit për të ofruar transmetim të pandërprerë të natyrës audio dhe audiovizive.
- Parimi i garantimit të integritetit të çështjeve gjinore, LGBTQ+ dhe të rinjtë.

Neni 4

Qëllimet kryesore të RTSH-së

Në arritjen e qëllimeve kryesore, veprimtaria e RTSH-së do të fokusohet në:

- a. Transmetimet audiovizive duke ju përgjigjur interesave dhe kërkesave të të gjithë popullatës, duke pasur në vëmendje garantimin e mirëkuptimit dhe paqes në Republikën e Shqipërisë e më gjerë, duke siguruar që programet e saj të pasqyrojnë elementet e ndryshme njerëzore, kulturore dhe në veçanti duke i kushtuar vëmendje të veçantë elementeve dalluesve të kulturës kombëtare dhe gjuhës shqipe, argëtimit dhe edukimit të publikut.
- b. Transmetimet audiovizive të cilat do të bëjnë të mundur informimin e publikut dhe kuptimit nga ana e tij të vlerave dhe traditave të vendeve të tjera, në veçanti ato europiane.
- c. Transmetimet audiovizive të cilat do të bëjnë të mundur mbulimin e pasqyrimin të veprimtarive sportive, fetare e kulturore.
- d. Transmetimet audiovizive të cilat do të bëjnë të mundur pasqyrimin e programe me lajme dhe çështje aktuale, në vend dhe jashtë, përfshirë mbulimin e veprimtarive parlamentare.
- e. Ofrimin e informacionit nëpërmjet faqes së internetit, në lidhje me shërbimet që ajo mundëson, ku dhe do të sigurojë përditësimin dhe mirëmbajtjen e kësaj faqeje.
- f. Në mirëmbajtjen e Orkestrës Simfonike të RTSH-së dhe të kujdeset që roli i saj në edukimin dhe zhvillimin e jetës artistike të jetë në nivele të larta profesionale.
- g. Në bashkëpunimin me institucione të ndryshme publike, që në rastet e gjendjes së jashtëzakonshme, të mundësojë përgatitjen dhe shpërndarjen e informacionit përkatës për publikun.
- h. Në angazhimin e saj me përkushtim dhe seriozitet në dixhitalizimin e arkivave të saj si dhe në mirëmbajtjen e materialeve të cilat janë një pasuri kombëtare e që lidhen ngushtësisht me arritjen e qëllimeve gjatë veprimtarisë së saj.
- i. Në krijimin dhe vënien në funksion të shërbimeve të transmetimeve lokale apo rajonale, për kategori ose grupime të ndryshme shoqërore, të cilat do të jenë pa pagesë.

Neni 5

Platforma e transmetimeve të RTSH-së

- a. RTSH ka ngritur, mirëmban dhe ka vënë në funksion stacione të transmetimit numerik tokësore për përdorimin e rrjeteve të komunikimit elektronik, si dhe shërbimin kombëtar të transmetimeve audio dhe audiovizive të veta nëpërmjet multiplekseve. Ky është një shërbim

transmetimi pa pagesë për publikun. RTSH transmeton 14 Programe audio-vizive dhe 11 programe Audio në paltformën DVB-T2

- b. RTSH mirëmban dhe transmeton 11 programe audio dhe 5 programe audiovizive në platformën Satelitore.

Neni 6 Katalogu i Programeve

Në përputhje me detyrimet ligjore, kërkesat e publikut, standartet bashkëkohore, kushtet teknologjike dhe mjetet financiare në dispozicion, RTSH do të bëjë të mundur që brenda afatit të kësaj kontrate të ofrojë në platformat DVB-T2 dhe DVB-S2: **6 programe HD, 9 programe SD dhe 11 programe audio**, prodhime të vetë RTSH-së, duke përcaktuar dhe numrat logjikë të tyre, si më poshtë vijon:

Nr.	Program	NLP	Platforma Transmetuese
1	RTSH 1 HD	1	DVB-T2
2	RTSH 2 HD	2	DVB-T2
3	RTSH 24 HD	3	DVB-T2
4	RTSH Sport HD	31	DVB-T2/ DVB-S2
5	RTSH Film SD	34	DVB-T2
6	RTSH Muzikë SD	36	DVB-T2/ DVB-S2
7	RTSH Shqip SD	35	DVB-T2/ DVB-S2
8	RTSH Fëmijë SD	32	DVB-T2
9	RTSH Kuvend SD	41	DVB-T2
10	RTSH Shkollë HD	33	DVB-T2/ DVB-S2
11	RTSH Korça SD	37	DVB-T2
12	RTSH Kukësi SD	40	DVB-T2
13	RTSH Gjirokastra SD	38	DVB-T2
14	RTSH Shkodra SD	39	DVB-T2
15	RTSH SATELIT HD	-	DVB-S2
16	Radio Tirana 1	91	DVB-T2/ DVB-S2
17	Radio Tirana 2	92	DVB-T2/ DVB-S2
18	Radio Tirana Internacional	97	DVB-T2/ DVB-S2
19	Radio Tirana Klasik	94	DVB-T2/ DVB-S2
20	Radio Kukësi	96	DVB-T2/ DVB-S2
21	Radio Tirana Jazz	95	DVB-T2/ DVB-S2
22	Radio Tirana 3	93	DVB-T2/ DVB-S2
23	Radio Tirana Fëmijë	98	DVB-T2/ DVB-S2

24	Radio Korça	99	DVB-T2/ DVB-S2
25	Radio Gjirokastra	90	DVB-T2/ DVB-S2
26	Radio Shkodra	89	DVB-T2/ DVB-S2

1. RTSH 1 (Tokësor)

Kanali RTSH 1 është një kanal gjeneralist kryesor me shtrirje dhe interes të gjerë, që ka për qëllim të edukojë çdo brez, nga më të vegjëlit tek më të moshuarit, duke dhënë akses për të gjithë përmes programeve me cilësi të lartë. Hapësirat që do i dedikohen secilit target grupi nëpër fashat orare të përcaktuara, do të jenë në një spektër gjithëpërfshirës me edicione informative, me emisione politike dhe ato të tipit talk shoë, ku do të trajtohen ngjarjet më në zë të momentit në vendin tonë, nga rajoni dhe bota, fenomenet dhe problematikat më shqetësuese për shqiptarët, me emisione ekonomike, social kulturore, sportive dhe argëtuese për publikun.

RTSH 1 HD do të ofrojë një gamë të gjerë programesh, të zhanreve të ndryshme, duke u nisur nga emisionet me karakter informues, edukativ, kulturor e argëtues, dokumentarë, reportazhe, filma artistikë, prodhime origjinale, ngjarje ekskluzive dhe shumë bashkëpunime si partner mediatik i një sërë ngjarjesh artistike në kryeqytet e më gjerë. Gjithashtu, RTSH 1 HD synon në vazhdimësi t'i ofrojë publikut të gjerë lajme të sakta dhe të pavarura. Përmes 6 edicioneve informative, ofrohen çdo ditë 130 minuta lajme që pasqyrojnë me vërtetësi dhe profesionalizëm realitetin shqiptar, rajonal e ndërkombëtar.

2. RTSH 2 (Tokësor)

Kanali RTSH 2 është një kanal gjeneralist që realizon dhe transmeton programe që pasqyrojnë të gjitha ngjarjet që kanë të bëjnë me çështjet sociale , politike, shoqërore, kulturore të cilat i dedikohen minoriteteve, folklorit dhe traditës shqiptare, diversitetit, religjionit dhe bashkëjetesës fetare, personave me aftësi ndryshe dhe LGBTQ. Ky kanal transmeton gjithashtu edicione informative në gjuhët përkatëse për pakicat serbe, maqedonase, bullgare, arumune, rome dhe egjiptiane, malazeze, greke, boshnjake. Ky kanal transmeton edhe programe që lidhen me jetën e bashkatdhetarëve, aktivitetet e Diasporës, politikat integruese të shqiptarëve, ruajtjen e traditave, lidhjen me vendin dhe aktualitetin, evidentimin e vlerave shqiptare në arenën ndërkombëtare.

Ky kanal ka si qëllim të ofrojë një sërë programesh informative dhe çështjeve aktuale, si brenda vendit ashtu dhe jashtë për bashkatdhetarët, duke përfshirë dhe mbulimin e aktiviteteve të Kuvendit. Po ashtu, ky kanal do të ofrojë shërbimin e transmetimit të programeve audio për shqiptarët jashtë vendit, nëpërmjet programeve kulturore, programe të cilat pasqyrojnë jetën e bashkatdhetarëve në botë, traditat, kulturën, aktivitetet dhe politikat integruese të shqiptarëve jashtë vendit. Në këtë kanal, janë menduar emisionet që kanë fokus lokal, ku do të përfshihen të rinjtë në qytetet e Shqipërisë, por edhe emisione me tematika sociale që nxjerrin në pah problematikat e rretheve, pse jo dhe në këtë kanal mund të transmetohen programet e katër kanaleve vendore.

3. RTSH Sport (Tokësor)

Kanali RTSH Sport është kanal tematik sportiv që synon të promovojë shumëllojshmërinë e aktiviteteve sportive me rëndësi kombëtare dhe të transmetojë të gjithë evenimentet sportive kombëtare dhe ndërkombëtare, duke u nisur nga kompeticionet europiane deri te kampionatet botërore, Olimpiadat dhe programe të blera me të gjithë të drejtat nga RTSH. Ky kanal është i fokusuar në realizimin dhe transmetimin e lajmeve sportive ditore, lidhjeve direkte nga ngjarjet e rëndësishme sportive, emisioneve të ndryshme informative, emisione me analiza dhe komente në studio, emisione edukuese, argëtuese, dokumentarë dhe reportazhe sportive nga vendi dhe bota. Si partner mediatik i të gjithë federatave sportive kombëtare, pasqyron të gjithë aktivitetet e tyre kombëtare dhe veprimtaritë sportive të ekipeve në cdo disiplinë sportive, duke qenë shpeshherë i vetmi kanal që ofron këtë llojshmëri disiplinash sportivesh. RTSH Sport është i dedikuar 24 orë vetëm ngjarjeve sportive, dhe sipas një llogaritje shpërndarja e strukturës programore gjatë vitit është:

10% edicionet informative = 900 orë në vit

15% emisionet tematike = 1300 orë në vit

45% ngjarjeve të drejtpërdrejta sportive nga vendi = 3900 orë në vit

30% ngjarje të drejtpërdrejta sportive nga bota = 2600 orë në vit

4. RTSH Film (Tokësor)

Kanali RTSH Film është konceptuar si një kanal i dedikuar tërësisht publikut të apasionuar pas filmit dhe kinemasë së huaj, duke synuar që të jetë dritarja kryesore e kinematografisë ndërkombëtare në të cilin do të ketë gjithëpërfshirje të zhanreve, metrazheve dhe formave të ndryshme të filmit, dokumentarëve apo serialeve. Filmi me metrazh të gjatë është elementi kryesor në hartimin e programacionit ditor e javor. Transmetimi dhe ritransmetimi i çdo filmi bëhet mbi filozofinë që t'u përshtatet orareve jetësore të audiencës së këtij filmi dhe që audienca e interesuar për të, të mos e humbasë.

Larmishmëria në gjini, formë dhe përmbajtje e bën këtë kanal që të ketë një target të gjerë audience duke iu afruar kështu jo vetëm të rriturve, por edhe gjithë familjes, të rinjve, adoleshentëve, fëmijëve, si dhe një publiku specifik dashamirës të filmit dhe dokumentarit të huaj.

5. RTSH Shqip (Tokësor, Satelitor)

Kanali RTSH Shqip i dedikohet prodhimtarisë artistike shqiptare ndër vite duke sjellë 24 orë, çdo ditë, nostalgjinë e kinemasë ndërthurur natyrshëm me prodhimet e reja të kinematografisë shqiptare, shfaqjet teatrale, serialët, dokumentarët dhe telekomeditë, të gjithë këto zhanre, prodhime ose bashkëprodhime të RTSH-së. Ky kanal e shtrin skaletën e programacionit të tij në

zhanre të ndryshme dinamike: rrëfimet-biografi, nostalgjinë e pelikulës së vjetër, historinë, dramën familjare të viteve '70-të-'90-të, veprat më të realizuara të vëna në skenën e teatrit, komedi ndër vite e shumë të tjera. Transmetimi dhe ritransmetimi i çdo materiali artistik zhvillohet mbi filozofinë e cila u përshtatet orareve jetësore të audiencës dhe interesit të saj për të mos u humbur. Ky kanal do të ofrojë një hapësirë nostalgjie, me programacion javor e cila do të vijë e konceptuar si një program i mirëfilltë ku publiku do të rikujtojë ose shohë për herë të parë prodhimet kult të Radio Televizionit Shqiptar.

6. RTSH Muzikë (Tokësor, Satelitor)

Kanali RTSH Muzikë është i vetmi i platformës digjitale, i cili transmeton 100% muzikë dhe formate muzikore. Kanali RTSH Muzikë i dedikohet krijimtarisë muzikore të vendit dhe të huaj duke realizuar dhe transmetuar koncerte, ngjarje muzikore me rëndësi kombëtare e ndërkombëtare dhe rubrika që i shërbejnë traditës kombëtare, zhvillimit të tyre, ruajtjes dhe përhapjes dhe transmetimit të vlerave artistike të folklorit, me synimin për të kënaqur shijet e të gjithë shikuesve. Ky kanal ka për qëllim të sjellë një programacion me karakter muzikor që shkon përkrah misionit të argëtimit dhe edukimit të publikut të RTSH-së.

7. RTSH Kuvend (Tokësor)

Kanali RTSH Kuvend i dedikohet tërësisht zhvillimeve parlamentare në Shqipëri duke transmetuar në lidhje direkte seancat plenare, duke pasqyruar debatet dhe punimet e ndryshme të komisioneve parlamentare apo edhe aktivitetet zyrtare brenda apo jashtë vendit të kryetarit të parlamentit. RTSH Kuvend transmeton çdo javë aktivitetet e parlamentit edhe në gjuhën e shenjave. Në objektivat e tij ky kanal synon realizimin dhe transmetimin e përmbledhjeve javore të veprimtarisë parlamentare, emisione me analiza dhe komente me ekspertë të fushës apo antëtarë të Kuvendit të Shqipërisë mbi projektligjet dhe ligjet e miratuara me interes për publikun.

8. RTSH 24 (Tokësor, Satelitor)

Kanali RTSH 24, si një televizion informativ, transmeton edicione lajmesh të drejtpërdrejta 24 orë në 24 për përçimin e lajmit në mënyrë të shpejtë, të saktë dhe të pavarur përmes transmetimeve direkte të të gjithë eventeve/ngjarjeve brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe thellimin e tij në studio përmes bisedave, analizave dhe intervistave. Pjesë e transmetimeve janë edhe materialet speciale për ngjarje të ndryshme apo reportazhe për vende, turizmin, historinë, kulturën sportin etj. Programacioni i kanalit nuk është i fiksuar për shkak të ngjarjeve që nuk janë të parashikuara, por pjesë e grilës programore janë dy edicione me lajmeve sportive, emisione tematike për ekonominë, aktualitetin, teknologjinë, rajonin etj.

9. RTSH Fëmijë (Tokësor)

Kanali RTSH Fëmijë është një kanal i dedikuar grup-moshës 2-12 vjeç dhe ka si synim argëtimin dhe edukimin e fëmijëve të këtij target grupi, duke realizuar dhe transmetuar emisione me programacion të larmishëm me qëllim ofrimin e alternativave të reja për të stimuluar njohuritë, fantazitë, krijimtarinë, zhvillimin e pasioneve si dhe duke transmetuar seriale dhe filma të animuar me personazhet më të dashur për këtë grup-moshë.

Ky kanal pritet që të përfshijë në programet për fëmijë grup-moshën 12 deri në 14 vjeç, ku programi të drejtohet nga fëmijët e këtyre moshave, por të jetë me minutazh të shkurtër.

10. RTSH Shkollë (Tokësor, Satelitor)

Kanali RTSH Shkollë ka si qëllim edukimin, informimin dhe argëtimin e një moshe të përcaktuar si mosha shkollore duke përfshirë edhe moshën parashkollore dhe atë universitare/ rinore. Ky kanal është i orientuar drejt emisioneve edukative. Leksionet e xhiruara të kurrikulës shkollore zënë një pjesë të madhe të orëve të transmetimit. Po ashtu emisionet për mësimin e gjuhëve të huaja. Dokumentarët do të zënë një vend të rëndësishëm në ekranin e RTSH Shkollë dhe do të jenë të përzgjedhur në përshtatshmëri me moshat shkollore dhe rinore duke përcjellë një larmishmëri temash edukuese si historia, gjeografia, arti, kulturat e ndryshme nëpër botë, anti-racizmi dhe anti-bulizmi, udhëtimet, shkenca, teknologjia etj. Përveç tematikës ky kanal duhet të ketë parasysh edhe cilësinë e lartë të transmetimit pasi shikuesi të cilit i referohet ky kanal është shumë i ndjeshëm për sa i përket cilësisë së figurës dhe zërit, duke qenë se janë brezi i “teknologjisë” dhe jo i “nostalgjisë”. Ky kanal do të pasurohet me programe argëtimi, Quizz-e apo konkurse midis nxënësve e studentëve, po ashtu realizimi i reportazheve me fëmijë dhe të rinj të cilët zhvillojnë dhe hobe të ndryshme.

11. RTSH Satelit (Satelitor)

Kanali RTSH Satelit i qëndron besnik linjës së programit të kanalit të parë gjeneralist RTSH 1 HD. Kanali satelitor zëvendëson vetëm materialet për të cilat RTSH nuk ka të drejta transmetimi jashtë vendit, si filmat dhe dokumentarët e huaj. Në vend të tyre transmetohen materiale televizive shqiptare të marra nga arkivi i RTSH-së. Ky kanal ka në fokus edhe programe për Diasporën dhe gjithashtu transmeton dhe eventet më të rëndësishme të platformës, si Festivali i Këngës në RTSH. Gjithashtu, një vend të rëndësishëm zënë dhe materialet që synojnë të promovojnë zhvillimin e vendit, traditën, kulturën, ndjenjën e patriotizmit e qytetarisë nëpërmjet të gjitha gjinive televizive.

12. RTSH Kukësi (Tokësor)

Kanali RTSH Kukësi konsiston në transmetimin çdo ditë të edicioneve informative me zhvillimet më të fundit nga ky rajon, të emisioneve me tematikë sociale, kulturore, politike, argëtuese, transmetimin e filmave, dokumentarëve apo materialeve arkivore të RTSH-së që trajtojnë traditat dhe muzikën e kësaj zone të vendit. Transmetimi i programeve me karakter lokal zë 20% (2 orë në ditë) të gjithë programit ditor, duke përfshirë speciale, reportazhe, kronika, dhe lajme. I gjithë ky program që dhe ritransmetohet është i prodhuar nga gazetarët tanë, me gjithë larminë e tematikave të zhvillimeve të aktualitetit, arsimit, shëndetësisë, sportit dhe shumë reportazhe intervista që realizohen, kryesisht në qarkun Kukës dhe në Kosovë nga redaksia jonë.

Transmetimi i programeve me karakter kombëtar zë 80 % (12 orë në ditë) të programit ditor, duke përfshirë dokumentarë, reportazhe, muzikë, filma, teatër. Të gjitha këto nga arkivi RTSH-së.

Në RTSH Kukësi, ka ende mangësi teknike dhe aparatura që çalojnë dhe pengojnë punën në krijimin e arkivës me problematikë dhe ngjarje rajonale.

Megjithatë në 2 vitet e fundit kanë rritur sasinë e prodhimeve televizive me tematikë lokale dhe tashmë kemi një miniarkiv tonin mjaft të pasur.

Në ekran nuk kanë dhe mundësinë teknike për të transmetuar drejtpërdrejt, kështu që raporti i transmetimeve me tematikë lokale është shumë më i vogël se i transmetimeve me tematikë kombëtare.

13. RTSH Korça (Tokësor)

Kanali RTSH Korça, mbulon dhe transmeton programe, të cilat pothuajse 90/100% janë prodhime të Qendrës Vendore Audiovizive Korçë. Normalisht çdo ditë, rreth 6 orë e 30 minuta në ditë, prodhohen programe ditore. Ky kanal transmeton emisionine mëngjesit, çdo ditë edicionine lajmeve, tre edicione, nga 90 minuta, Podcast-e, (emisione të ndryshme), si dhe nga e hëna në të premte, ka emisionine vet, ndërsa i është ndaluar dhënia e filmave shqiptarë.

Përveç sa më sipër, ky kanal transmeton shfaqje teatrore, një cikël emisionesh prodhimi i të cilëve daton para 20 viteve dhe herë pas here ndonjë dokumentar. Në edicionin e lajmeve përdoret kronikë dhe materiale që i xhiron vetë dhe rrallë herë, merr materiale për edicion lajmesh nga RTSH-ja, vetëm në raste madhore si dhe për ndeshjet e futbollit. Materialet e marra nga Qendra, si festivalet evropiane të këngës i kanërikompozim.

Për pakicat kombëtare, në televizion ka vetëm edicion lajmesh në gjuhën maqedonase. Ka pasur kërkesa nga komunitetet minoritarë bullgar dhe grek, por nuk ka ende emisione të veçanta në QVA-në e Korçës. Rreth 55-60% e programit të RTSH Korça e zënë emisionet apo veprimtaritë me karakter vendor.

14. RTSH Shkodra (Tokësor)

Kanali RTSH Shkodra është pjesë e paketës RTSH, dhe si kanal gjeneralist ruan një raport të drejtë në programacion mes programeve, informacioneve me frymë dhe përmbajtje thjesht lokale apo me përfshirje më të gjerë kombëtare. Pjesa më e madhe e programacionit ka përmbajtje lokale (qarku i Shkodrës me qendër këtë qytet dhe bashki por edhe nga bashkia e Malësisë së Madhe, Vau Dejës, etj.).

Ndërkohë, prodhimet e RTSH, lajme, lidhje direkte, speciale, reportazhe, emisione në studio, janë tërësisht me përmbajtje lokale/rajonale. Më specifikisht, këtu përfshihen: Edicionet e lajmeve (tri herë në ditë të plota dhe një herë në mëngjes ritransmetimi vetëm kronikat pa spiker në studio); Lidhjet direkte të përditshme në RTSH 24 dhe Radio Tirana si dhe ato periodike me emisionin e mëngjesit në RTSH 1; reportazhet dhe specialet e realizuara nga gazetarët tanë në terren, të cilët janë të përjavshëm (2- 4 prodhime); emisionet me fokus histori njerëzore me personazhe nga rajoni ynë, ngjarje dhe aktivitete nga jeta politike, sociale, kulturore, historike, ekonomike, sportive, të rendit publik nga qarku i Shkodrës; aktivitete kulturore, koncerte, veprimtari artistike, sportive, festivale zhvilluar në Shkodër dhe xhiruar nga stafi i operatorëve dhe teknik i QVA Shkodër dhe montuar nga RTSH dokumentarë historikë, të personaliteteve të muzikës, artit, letërsisë, politikës, jetës shoqërore, sportive nga rajoni i Shkodrës prodhuar ndër vite nga regjisorë dhe operatorë të RTSH-së. Jo më pak se 60% e programacionit të RTSH Shkodra është me fokus lokal/rajonat.

15. RTSH Gjirokastra (Tokësor)

Kanali RTSH Gjirokastra, pjesën më të madhe të programacionit e realizon nga redaksia vendore dhe bashkëpunëtorët lokalë, në funksion të përmbushjes së misionit publik për informim, edukim dhe promovim të vlerave të zonës jugore. Raporti aktual i prodhimeve lokale me ato qendrore: Bazuar në monitorimin e brendshëm të programacionit, rreth 60 % e minutazhit javor të RTSH-së, Gjirokastra përbëhet nga përmbajtje e prodhuar në vend, ndërsa pjesa tjetër merret nga arkiva dhe transmetimet e RTSH-së.

Programet në Audio

1. Radio Tirana 1 (Tokësor, Satelitor)

Kanali Radio Tirana 1 pasqyron diversitetin e shoqërisë shqiptare duke realizuar dhe transmetuar emisione me qëllim informim, edukim dhe argëtim në formatin e talk shoë, debateve, studio të hapur në shërbim të të gjithë dëgjuesve të çdo grup- moshe.

2. Radio Tirana 2 (Tokësor, Satelitor)

Kanali Radio Tirana 2 i dedikohet muzikës më të mirë shqiptare, kulturës dhe aktorëve të saj me qëllim argëtimin, edukimin e dëgjuesve dhe jo vetëm. Në programin e saj përfshihet edhe një hapësirë informative ku pasqyrohet të rejat e fundit mbi muzikën shqiptare.

3. Radio Tirana 3 (Tokësor, Satelitor)

Kanali Radio Tirana 3 i dedikohet bashkatdhetarëve jashtë kufijve të Shqipërisë. Ky kanal ka si objektiv pasqyrimin e problematikave dhe interesave të bashkëkombësve dhe diasporës, nëpërmjet emisione direkte, Talk Show, duke trajtuar çështje për edukimin, gjuhën, kulturën, turizmin dhe biznesin për të përmbushur interesat e shqiptarëve jashtë kufijve të Shqipërisë.

4. Radio Tirana Klasik (Tokësor, Satelitor)

Kanali Radio Tirana Klasik konsiston në transmetimin e programeve me muzikë klasike, me kohëzgjatje 24 orë në 24 dhe do të përmbajë repertorin më të mirë të muzikës klasike botërore dhe shqiptare të ekzekutuar nga Orkestra Simfonike e RTSH-së por edhe nga orkestra të tjera europiane dhe botërore.

5. Radio Tirana Fëmijë (Tokësor, Satelitor)

Kanali Radio Tirana Fëmijë konsiston në transmetimin e programeve për të plotësuar interesat dhe pasionet e fëmijëve duke ofruar emisione që do të alternojnë të mësuarit dhe lojën, argëtimin dhe angazhimin e tyre në gjithçka. Ky kanal do të jetë me kohëzgjatje 24 orë në 24 dhe do të përfshijë transmetimin e programeve me gjëra të thjeshta, si të drejtuarit atyre pyetje, marrja e vendimeve dhe të menduarit në mënyrë të pavarur duke kontribuar në përgatitjen e tyre për vitet e ardhshme.

6. Radio Tirana Jazz (Tokësor, Satelitor)

Kanali Radio Tirana Jazz për publikun shqiptar konsiston në transmetimin e programeve me muzikë jazz me kohëzgjatje 24 orë në 24 që do të përcillet në zonën e mbulimit, sipas të dhënave teknike për rrjetin e transmetimit tokësor DVB- T2 të RTSH-së.

7. Radio Tirana Internacional (Tokësor, Satelitor)

Kanali Radio Tirana Internacional është radio që transmeton në shtatë gjuhë të huaja: anglisht, gjermanisht, frengjisht, italisht, turqisht, greqisht dhe serbisht. Ky kanal synon transmetimin e informacioneve për Shqipërinë për një audiencë dhe publik të huaj përmes emisioneve informative, transmetimeve dhe programeve radio të veçanta, promovimi i imazhit të vendit, vlerave kulturore shqiptare, traditës, si edhe i turizmit dhe gjithçkaje që një publik i huaj ka nevojë të dijë për Shqipërinë.

8. Radio Korça (Tokësor, Satelitor)

Kanali Radio Korça do të transmetojë 24 orë në ditë, duke ofruar shërbime cilësore audio, për të informuar, edukuar dhe argëtuar publikun e zonës. Prodhimi i programeve i dedikohet eventeve, ngjarjeve të cilat zhvillohen në këtë rajon duke patur si fokus përcjelljen e jetës ekonomike, sociale, kulturore, sportive, politike me saktësi dhe në kohë. Radio Korça transmeton edicione lajmesh në gjuhën maqedonase dhe në gjuhën e komunitetit vllah.

9. Radio Gjirokastra (Tokësor, Satelitor)

Kanali Radio Gjirokastra do të transmetojë 24 orë në ditë duke ofruar programe cilësore audio për të edukuar, argëtuar dhe informuar publikun e zonës për çështjet më tematike, politike, ekonomike, sociale, kulturore të cilat zhvillohen në qarkun e Gjirokastrës dhe jo vetëm. Në programin e saj përfshohet edhe transmetimit i emisioneve të ndryshme në gjuhën shqipe, greke dhe aрумune.

10. Radio Shkodra (Tokësor, Satelitor)

Kanali Radio Shkodra do të transmetojë 24 orë në ditë duke ofruar programe cilësore audio për të edukuar, argëtuar dhe informuar publikun e zonës për çështjet me tematikë politike, ekonomike, sociale, kulturore dhe ngjarjeve të cilat zhvillohen në qarkun e Shkodrës dhe jo vetëm.

11. Radio Kukësi (Tokësor, Satelitor)

Kanali Radio Kukësi do të jetë një program audio me kohëzgjatje 24 orë në 24, duke ofruar programe cilësore audio për të edukuar, argëtuar dhe informuar publikun e zonës për çështjet me tematikë politike, ekonomike sociale, kulturore dhe ngjarjeve të cilat zhvillohen në qarkun e Kukësit dhe jo vetëm.

Neni 7

Programet aktuale të RTSH-së

Bazuar në strukturat programore të miratuara me anë të vendimeve të KDRTSH-së, për transmetimet në platformën e RTSH-së, RTSH merr përsipër të ofrojë gjatë transmetimeve të saj:

- a. Programe që kanë të bëjnë me **shkencën, arsimin e teknologjinë**. Këto do të trajtohen në emisione kushtuar arsimit, po ashtu dokumentarë, reportazhe të ndryshëm të cilët do të përqendrohen në zhvillimet shkencore e teknologjike ndër vite, porse dhe risitë e zhvillimet e tanishme. Në harkun kohor prej një viti, programe të tilla do të zënë përkatësisht **3520 orë** apo **3.65%**, nga të cilat 260 orë në Kanalin e Parë, RTSH1HD dhe 3260 orë në kanalet e tjera si RTSH-Shkollë, RTSH-Satelit, etj.

- b. Programe që kanë të bëjnë me **zhvillimin e edukimin e fëmijëve**. Këto do trajtohenpërmes emisioneve të posaçme, me të ftuar të profesioneve të ndryshme si sociologë, psikologë, punonjës socialë, drejtues të sistemit arsimor parashkollor e atij shkollor, prindër apo drejtues të niveleve të lartatë institucioneve shtetërore që kanë lidhje të drejtpërdrejtë me politikate zhvillimit dhe të edukimit të fëmijëve. Por gjithashtu do synohet edhe argëtimi përmes mësimi ku kryefjalë do jenë vetë fëmijët. Në harkun kohor prej një viti, programe të tilla do të zënë përkatësisht **16358 orë**, ose **16.98%**, nga të cilat 481 orë janë në kanalin e Parë, RTSH1HD dhe pjesën e mbetur në kanalet e tjera (RTSHFëmijë, RTSH Shkollë, RTSHMuzikë, RTSH Satelit).
- c. **Programe sportive**. Këto do të vijnë për publikun, përmes transmetimve të ngjarjeve ekskluzive sportive, për të cilat RTSH ka siguruar të drejtat e transmetimit dhe përmes programeve televizive sportive që pasqyrojnë përzhvillimet sportive brenda Republikës së Shqipërisë e po ashtu edhe ato evropiane e botërore. Në harkun kohor prej një viti, programe të tilla do të zënë përkatësisht **9514 orë apo 9.87%**.
- d. **Prodhimet filmike**. Transmetimi i dokumentarëve, filmave të ndryshëm shqiptarë e tëhuaj, që trajtojnë tematika të ndryshme social-kulturore. Në harkun kohor prej një viti, programe të tilla do të zënë përkatësisht **25290 orë, ose 26.25 %**, nga të cilat 1599 orë në Kanalin e Parë dhe pjesa tjetër në kanalet RTSH Film, RTSH Shqip, RTSH Satelit, RTSH2.
- e. **Art, histori, gjeografi** - Transmetimi i emisioneve, që trajtojnë tematika të ndryshme social-kulturore (zakonet, traditat si shenjë identiteti, njohja e monumenteve të kulturës sonë, trajtimi i problemeve të ndryshme që hasin bashkëkombësit, emigrantët, minoritetet etj), historike, gjeografike, artistike. Në harkun kohor prej një viti, programe të tilla do të zënë përkatësisht **1524 orë, ose 1.58%**, nga të cilat 338 orë në Kanalin e Parë, RTSH1HD dhe pjesa tjetër në kanalet RTSH2, RTSHSatelit.
- f. **Transmetime muzikore**. Do të vijnë për publikun përmes koncertevesimfonike, të festivaleve, koncerteve e recitaleve muzikore, prodhime e bashkëprodhime të RTSH-së, si dhe organizimi i konkurseve të ndryshme mbi muzikën popullore e atë të lehtë. Në harkun kohor prej një viti, programe të tilla do të zënë përkatësisht **9826 orë, ose 10.20%**, nga të cilat 338 orë në Kanalin e Parë, RTSH1HD dhe pjesa tjetër në kanalet RTSH Muzikë, RTSH2, RTSHSatelit.
- g. **Emisione Aktualiteti** - Transmetimi i emisioneve të aktualitetit me **karakter ekonomik, politik, ekonomik**, duke pasqyruar situatën aktuale, si dhe elementë të kuadrit ligjor në vend, **biznesin, turizmin, sfida për cashless, edukimi bankar, financiar** etj. Në harkun kohor prej një viti, programe të tilla do të zënë përkatësisht **10684 orë, apo 11.09%**.
- h. Transmetime të zhvillimeve **shëndetësore**, të cilatdo të sjellin emisione me karakter informues e këshillues për sëmundje të veçanta, ku publiku do të përditësohet jo vetëm me praktikat më të fundit brenda e jashtë vendit, porse dhe me mënyrat e diagnostikimit e kujdesin e nevojshëm, për trajtimin e problematikave shëndetësore. Në harkun kohor prej një viti, programe të tilla do të zënë përkatësisht **416 orë, ose 0.43%**.

- i. **Argëtim (Emisione të përditshme / Spektakle)** - Emisione të përditshme ku përfshihen tematika të ndryshme argëtuese, sociale, **ekonomike** që e deri te spektakli e showbizi. Në harkun kohor prej një viti, programe të tilla do të zënë përkatësisht **4160 orë**, ose **4.32%**, nga të cilat 338 orë në Kanalën e Parë, RTSH1HD dhe pjesa tjetër në kanalet RTSH Muzikë, RTSH2, RTSHSatelit.
- j. Transmetimi i emisioneve kushtuar **librit**, ku do të trajtohen gjërësisht me anë të shkrimtarëve të ndryshëm, arti në shprehjen e fjalës nëpërmjet shkrimtarëve shqiptarë dhe të huaj, si dhe njohja e publikut me botimet më të reja. Në harkun kohor prej një viti, programe të tilla do të zënë përkatësisht **208 orë apo 0.22%**.
- k. **Shtresat në nevojë** - Transmetimi i emisioneve duke trajtuar problematikën dhe vështirësitë që hasin njërezit në nevojë dhe ata me aftësi të kufizuar dhe mundësitë që u duhen dhënë për integrimin e tyre në shoqëri. Në harkun kohor prej një viti, programe të tilla do të zënë përkatësisht **755 orë ose 0.78%**.
- l. **Gjuhë të huaja** - Transmetimi i programeve të ndryshme audio ose audiovizive në 7 gjuhë të ndryshme, anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, turqisht, serbo-kroatisht dhe greqisht për informimin e të interesuarve të huaj për **zhvillimet ekonomike** dhe politike të Shqipërisë. Në harkun kohor prej një viti, programe të tilla do të zënë përkatësisht **487 orë ose 0.51 %**.
- m. **Lajme nga vendi dhe Bota** – Aktualitet. Edicione informative sipas orareve të mirëpërcaktuara në kanalet tona. Në harkun kohor prej një viti, programe të tilla do të zënë përkatësisht **11527 orë ose 11.96%**.
- n. **Promocion dhe reklamë**. Koha televizive e parashikuar për promovimin e programeve televizive dhe reklamave me pagesë. Në harkun kohor prej një viti, parashikohet, që hapësirat e promocionit dhe reklamave të zënë përkatësisht **2091 orë ose 2.17%**.

Neni 8

Botimet dhe shpërndarja

Përgatitja, botimi dhe shpërndarja e shtypshkrimeve e të paktën një reviste dhe një broshurë me qëllim promovimin e emisioneve të ndryshme me njohjen e tematikave që do të trajtohen në to, promovimin e spektakleve që do të organizojë apo në të cilat do të jetë bashkëprodhuese, trajtimin e evenimenteve artistike dhe kulturore që do të realizohen në kuadër të përmbushjes së qëllimit për të cilin është krijuar. Përgatitja e një reviste virtuale që mund të publikohet në website me qëllim promovimin e emisioneve të ndryshme për njohjen e tematikave që trajtohen në to, spektakleve që organizohen apo publikimin e eventeve artistike dhe kulturore por edhe pasqyrimin e trajnimeve që realizohen për rritjen profesionale të stafit, ku avantazhi i revistës online është se publikimet dhe informacioni mund të jetë i vazhdueshëm dhe përditësuar me qëllim informimin në kohë reale mbi aktivitetet që zhvillohen në RTSH.

Neni 9

Shpërndarja e materialeve audiovizive

Publikimi dhe shpërndarja e materialeve audiovizive të regjistruara, do të bëhet nga Drejtoria e Arkivës kundrejt tarifës së përcaktuar, me kërkesën e çdo personi që e paraqet atë me shkrim pranë Drejtorisë së Përgjithshme të RTSH-së. Kërkesat do të trajtohen në përputhje me parashikimet e neneve 14,15,16 dhe 17 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, të ndryshuar.

Neni 10

Pikat e transmetimit

Pikat e transmetimit, frekuencat dhe karakteristikat e tjera teknike të rrjetit që do të shfrytëzohet nga Radio Televizioni Shqiptar janë të përcaktuara saktësisht në Aneksin nr.1 që do t'i bashkëngjitet kësaj kontrate dhe është pjesë përbërëse e saj.

Neni 11

Përdorimi i rrjetit numerik të RTSH-së

1. RTSH mund të ofrojë shërbime në të ardhmen ku të ngrejë, të mirëmbajë dhe të vërë në funksionim, pas miratimit nga AMA, shërbime transmetimi lokale, rajonale apo për publikun dhe i kapshëm, për aq sa është e mundur, nga të gjithë individët në Republikën e Shqipërisë, shërbime të cilat duhet të jenë të lira.
2. RTSH merrpërsipër me anë të kësaj kontrate, që në rrjetin numerik kombëtar të saj, të mundësohet shfrytëzimi i këtij rrjeti për shërbimet me natyrë publike lokale, rajonale, apo për apo për publikun dhe i kapshëm, për aq sa është e mundur, nga të gjithë individët në Republikën e Shqipërisë, të cilat duhet të jenë të lira (free to air) dhe do të miratohen dhe do të përcaktohen si të tilla nga AMA.
3. RTSH merr përsipër me anë të kësaj kontrate që të bëhet i mundur përdorimi i rrjetit lokal të saj nga operatorë të tjerë bazuar në kontratat dypalëshe të lidhura me RTSH dhe në bazë të tarifave të miratuara nga AMA. I licencuari i shërbimit të transmetimit audio ose audioviziv i paguan RTSH-së tarifat periodike për përdorimin e infrastrukturës së transmetimit.
4. AMA, pas këshillimit me RTSH-në, mund t'i kërkojë kësaj të fundit të bashkëpunojë me një të licencuar për transmetime audio ose audiovizive, për përdorimin e mjeteve të infrastrukturës së shpërndarjes së sinjalit, për shërbimet e transmetimit audio ose audioviziv të licencës përkatëse.
5. Tarifat hartohen bazuar në parimet e transparencës, proporcionalitetit dhe mosdiskriminimit. Ato propozohen nga RTSH dhe miratohen nga AMA, e cila shprehet brenda 30 ditëve nga paraqitja e propozimit. Nëse AMA nuk shprehet brenda këtij afati, tarifat konsiderohen të miratuara.

Neni 12

Detyrimet e RTSH-së

1. RTSH merr përsipër detyrimin e zbatimit të masave rregulluese dhe të kriterëve të përcaktuara nga AMA për bashkëpërdorimin e infrastrukturës së transmetimit të RTSH-së.
2. RTSH merr përsipër të paraqesë çdo vit një raport pranë AMA-s, në lidhje me mbulimin gjeografik dhe mbulimin e popullsisë me shërbim audioviziv.
3. RTSH merr përsipër garantimin e cilësisë së shërbimit, duke zbatuar kushtet dhe standardet teknike të përcaktuara në aktet rregullatore të nxjerra nga AMA dhe standardet ndërkombëtare mbi cilësinë e shërbimit.
4. RTSH merr përsipër të paraqesë çdo vit një raport në AMA mbi treguesit e cilësisë së shërbimit dhe mënyrën e mbledhjes së raportimeve, ushtrimit të funksioneve të Këshillit për shikuesit dhe dëgjuesit, ankesave dhe sugjerimeve në lidhje me cilësinë e shërbimit dhe produktit.
5. RTSH-ja u rezervon veprave europiane, shumicën e kohës së tij të transmetimit, duke përjashtuar kohën e caktuar për lajme, ngjarje sportive, lojra, reklama dhe të shitjeve të drejtëpërdrejta në television.
6. RTSH merr përsipër të hartojë një plan lidhur me mirëmbajtjen dhe funksionimin e rrjetit në të cilin të përshkruhet mënyrat që do të përdorë operatori public për zgjidhjen e problemeve teknike në rrjetin e transmetimit, kohën e parashikuar për zgjidhjen e tyre, procedurën që do të ndiqet për zgjidhjen e ankesave.
7. RTSH merr përsipër të paraqesë pranë AMA brenda 3 muajve nga përfundimi i vitit financiar një raport mbi prodhimet e porositura gjatë vitit të kaluar nga fondi i prodhimit të pavarur gjatë vitit të kaluar dhe shumën e mbetur pa u shpenzuar.
8. RTSH merr përsipër të paraqesë pranë AMA brenda datës 30 prill të vitit kalendarik bilancin vjetor të vitit financiar.

Neni 12/1

Përgatitja e Kodeve të sjelljes

RTSH përgatit Kodin e Sjelljes, i cili përcakton standartet dhe praktikat që respektohen gjatë ofrimit të shërbimeve mediatike audio dhe audiovizive.

Kodi i sjelljes duhet: a) të jetë i konceptuar në mënyrë që të pranohet gjerësisht nga palët e interesuara;

b) të përcaktojë në mënyrë të qartë dhe të padyshimtë objektivat e tyre;

c) të garantojë respektimin e dinjitetit të njeriut, të drejtat dhe liritë themelore të një personi apo një grup personash në përputhje me legjislacionin në fuqi;

ç) të parashikojë një monitorim dhe vlerësim të rregullt, transparent e të pavarur të arritjes së objektivave të synuara;

d) të sigurojë një zbatim efektiv, përfshirë sanksione të efektshme dhe proporcionale.

Kodi i sjelljes publikohet dhe në faqen elektronike të RTSH-së.

Neni 13

Informacionet për personat me aftësi të kufizuar në shikim dhe dëgjim

1. RTSH merr përsipër që të paktën në një edicion informative të transmetuar gjatë 24 orëve, të bëjë të mundur marrjen e informacioneve nga personat me aftësi të kufizuar në shikim dhe dëgjim, duke siguruar transmetimin simultan nga personat e aftë për të komunikuar me ata dhe që do të pasqyrohet në një kuadrat të veçantë në ekran në dy programet e saj RTSH 1 dhe RTSH 2.
2. RTSH merr përsipër të informojë periodikisht AMA-n për masat e marra për përmbushjen e detyrimeve të parashikuara në pikat 1 dhe 2 të këtij neni brenda vitit kalendarik.

Neni 14

Hapësira e Mbulimit

RTSH merr përsipër me anë të kësaj kontrate, që programet e saj kombëtare, në respektim të përmbushjes së qëllimit të saj në ofrimin e shërbimit të transmetimit audio dhe audioviziv për publikun, të mbulojë territorin e banuar në Republikën e Shqipërisë sipas parashikimeve të nenit 121 të ligjit nr. 97/2013 “Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Neni 15

Amendimet e kontratës

RTSH dhe AMA bien dakord që në rast të ndryshimit me shërbime nga ana e RTSH-së, si në ndryshimin e emërtimeve të kanalit, në eljen e kanaleve të reja, zëvendësimin apo reduktimin e kanaleve ekzistuese, ashtu dhe në shtimin apo pakësimin e transmetimeve lokale apo rajonale, të miratuara paraprakisht nga Këshilli Drejtues i RTSH-së, të shprehen duke nënshkruar një shtesë kontratë në të cilën të jenë të përcaktuar saktë kanali i transmetimit, frekuenca e transmetimit dhe struktura programore e tij e detajuar. Kjo shtesë kontratë do të jetë pjesë përbërëse e kësaj kontrate dhe do të ketë afat vlefshmërie deri në përfundimin e kësaj kontrate.

Neni 16

Raportimi për prodhimet e pavarura

RTSH merr përsipër që prodhimet e pavarura të programeve audiovizive përgjatë një viti financiar, të specifikohen saktësisht me të gjitha elementet e kërkuar nga neni 123 i ligjit nr. 97/2013, datë 94.03.2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, dhe brenda 3 muajsh nga përfundimi i vitit financiar. RTSH do të paraqesë pranë AMA një raport të detajuar për këto prodhime të pavarura, emrin e shoqërisë ose personave të kontraktuar për këtë qëllim, përdorimin e fondit të prodhimit të pavarur gjatë vitit të kaluar dhe shumën e mbetur pa u shpenzuar, si dhe çdo çdo çështje tjetër që lidhet me këto prodhime të pavarura brenda kërkesave të ligjit.

Neni 17

Mbikëqyrja e kontratave të shërbimit mbi përdorimin e rrjetit numerik të RTSH

1. AMA ka të drejtën dhe detyrimin të mbikëqyrë zbatimin e kontratave të shërbimit mbi përdorimin e rrjetit numerik të lidhura mes RTSH dhe transmetuesve të tjerë për transmetimin e programeve të tyre.
2. AMA ka të drejtën e zgjidhjes së këtyre marrëveshjeve pa cënuar të drejtat e tyre të sanksionuara nga ligjet në fuqi.

Neni 18

Frekuencat e transmetimit

1. RTSH dhe AMA bien dakord me anë të kësaj kontrate se shërbimi i programeve të RTSH-së do të mbështetet në rrjetet e transmetimit sipas frekuencave të miratuara nga AMA, në zbatim të VKM nr.1187, datë 24.12.2020 “Për miratimin e planit kombëtar të frekuencave”.
2. RTSH do të zbatojë të gjitha parametrat teknike të përcaktuar në këtë kontratë.
3. RTSH do të lejojë zyrtarët e autorizuar nga AMA-s për të kontrolluar frekuencat dhe për të inspektuar ambjentet e transmetimit të RTSH-së, për të siguruar bashkëpunimin e nevojshëm.

Neni 19

Afati

Kjo kontratë do të jetë e vlefshme nga momenti i nënshkrimit të saj nga palët për një afat kohor prej 5 vjetësh, të përcaktuar si të tillë në nenin 117 të ligjit nr. 97, datë 04.03.2013 “Për mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.

Neni 20

Përfundimi i kontratës

1. Kontrata përfundon me mbarimin e afatit të saj të përcaktuar në nenin 19 të kësaj kontrate. Palët marrin përsipër detyrimin ligjor të përcaktuar në dispozitën e nenit 117 të ligjit nr. 97, datë 04.03.2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, që 30 ditë para mbarimit të afatit të kësaj kontrate, të hartojnë dhe të lidhin një kontratë të re me afat të njëjtë.
2. Palët marrin përsipër që mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë zbatimit të kësaj kontrate do të përpiqen t’i zgjidhin me mirëkuptim dhe me bisedime, në të kundërt kompetente për zgjidhjen e tyre do të jetë Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Neni 21

Dispozitat e fundit

1. Kjo kontratë do të interpretohet në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi në fushën e mediave audiovizive si dhe akteve të tjera nënligjore në zbatim të tij.
2. Çdo term i papërkufizuar në këtë kontratë do të ketë të njëjtin kuptim si aktet ligjore në fuqi në fushën e mediave audiovizive në Republikën e Shqipërisë.
3. Aneksat e kontratës do të jenë pjesë përbërëse dhe e pandashme e kësaj kontrate.
4. Kjo kontratë përpilohet në 21 (njëzet e një) nene, në gjuhën shqipe dhe në 2 (dy) kopje origjinale nga të cilat palët marrin secila nga 1 (një) kopje. Çdo njëra prej tyre ka përmbajtje dhe vlerë të njëjtë ligjore.

Për
RADIO TELEVISIONIN SHQIPTAR
DREJTORI I PËRGJITHSHËM

Eni VASHI



Palët

Për
AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE
KRYETARI
Armela KRASNIQI

Aneksi 1 - Stacionet e Transmetimit DVB-T2 (Vendndodhja, Fuqia, Frekuenca)

Nr.	Allotmenti	Referenca TX	Stacioni	Gjerësi Gjeografike (N)	Gjatësia gjeografike (E)	Lartësia e stacionit (m)	Fuqia maksimale e TX të Stacionit	Kanali i transmetimit MUX1	Frekuenca MUX1	Kanali i transmetimit MUX2	Frekuenca MUX2
1	SHKODER	AL001D-002	TARABOSHI	42°02'48.1"	19°26'58.5"	596	1100W	28	530MHz	41	634MHz
2	SHKODER	AL001D-003	MIDE	42°06'43.4"	19°58'25.7"	1678	1100W	28	530MHz	41	634MHz
3	SHKODER	AL001D-030	SELCE Tamara (Hoti)	42°23'27.7"	19°28'58"	1083	570W	28	530MHz	41	634MHz
4	SHKODER	AL001D-031	MABE	41°56'20.3"	19°34'35"	64	50W	28	530MHz	41	634MHz
5	SHKODER	AL001D-034	FUSHE ARRES	42°03'45.8"	20°02'25.3"	909	50W	28	530MHz	41	634MHz
6	KUKES	AL002D-004	TREGTANI	42°07'37"	20°22'20.3"	1177	570W	26	514MHz	32	562MHz
7	KUKES	AL002D-032	DOBRENJI	42°17'56.5"	20°09'42.6"	1246	570W	26	514MHz	32	562MHz
8	KUKES	AL002D-005	Q.PRUSHI	42°16'41.5"	20°22'13"	984	570W	26	514MHz	32	562MHz
9	KUKES	AL002D-035	TRUNCI	41°53'00.5"	20°23'28.3"	1235	570W	26	514MHz	32	562MHz
10	DIBER	AL003D-006	PESHKOPI (Arapaj)	41°37'26.4"	20°20'01"	1518	570W	38	610MHz	24	498MHz
11	DIBER	AL003D-008	BURRELI(Vinjolli)	41°37'54.1"	20°07'18.7"	1036	570W	38	610MHz	24	498MHz
12	DIBER	AL003D-036	PLANBARDOHE	41°27'37.6"	20°09'54.5"	1035	570W	38	610MHz	24	498MHz
13	LEZHE	AL004D-009	BALLDRENI	41°50'21"	19°37'01.8"	359	570W	43	650MHz	23	490MHz
14	LEZHE	AL004D-037	LURTHI	41°43'39.9"	19°49'40.9"	816	570W	43	650MHz	23	490MHz
15	LEZHE	AL004D-010	K.RRESHEN(Shpali)	41°50'19"	19°57'12.8"	773	570W	43	650MHz	23	490MHz
16	LEZHE	AL004D-038	PILLANA	41°41'37.7"	19°42'05.6"	135	50W	43	650MHz	23	490MHz
17	LEZHE	AL004D-039	KURBNESHI	41°46'52.2"	20°04'20.8"	1016	50W	43	650MHz	23	490MHz
18	LEZHE	AL004D-040	PERLATI	41°43'23.3"	19°57'40"	348	50W	43	650MHz	23	490MHz
19	TIRANA	AL005D-012	FUSHE DAIJI	41°21'36.3"	19°54'49.2"	1047	1100W	34	578MHz	21	474MHz
20	TIRANA	AL005D-041	MAJA RRABES(PREZA)	41°24'56.6"	19°40'43.4"	173	570W	34	578MHz	21	474MHz
21	TIRANA	AL005D-011	KODER ISHEM	41°32'12.1"	19°35'49.7"	213	570W	34	578MHz	21	474MHz
22	TIRANA	AL005D-042	LAPIDARI	41°17'53.3"	19°48'12.3"	325	570W	34	578MHz	21	474MHz
22.1	TIRANA	Përsëritës për Radio-Lini	QAFESHHTAMA	41°19'42.2"	19°25'29.3"	157	1W	34	578MHz	21	474MHz
23	TIRANA	AL005D-043	DURRES HILL(Arapaj Durrës)	41°18'21.7"	19°30'46.2"	82	50W	34	578MHz	21	474MHz
24	TIRANA	AL005D-013	KRYEVIDHI	41°05'21.9"	19°32'06"	176	570W	34	578MHz	21	474MHz
25	TIRANA	AL005D-012	DAJI	41°22'05"	19°55'20.7"	1574	50W	34	578MHz	21	474MHz
26	TIRANA	AL005D-044	SHESHI	41°18'42"	19°39'38.5"	470	50W	34	578MHz	21	474MHz
27	TIRANA	AL005D-045	PSV	41°19'42.2"	19°25'29.3"	145	570W	34	578MHz	21	474MHz
28	ELBASAN	AL006D-014	PETRESHI	41°06'44.7"	20°00'42.5"	518	1100W	23	490MHz	33	570MHz
29	ELBASAN	AL006D-015	LIBRAZHDI	41°11'37.4"	20°19'47.1"	510	570W	23	490MHz	33	570MHz
30	ELBASAN	AL006D-016	CERVENAKE	40°59'35.9"	20°35'40.3"	1514	1100W	23	490MHz	33	570MHz
31	ELBASAN	AL006D-046	GIUJAZ	40°59'58.8"	19°45'36.6"	269	570W	23	490MHz	33	570MHz
32	ELBASAN	AL006D-047	GRAMSHI	40°52'39.6"	20°09'21.6"	536	50W	23	490MHz	33	570MHz
33	FIER	AL007D-048	GRABJANI	40°57'23"	19°34'03"	175	570W	27	522MHz	31	554MHz
34	FIER	AL007D-017	ARDENICA	40°49'29.3"	19°35'37.3"	197	50W	27	522MHz	31	554MHz
35	FIER	AL007D-018	LIGOVUNI	40°39'52.3"	19°31'36.6"	319	570W	27	522MHz	31	554MHz
36	FIER	AL007D-019	BALLSHI KODER	40°35'42.5"	19°42'35.4"	597	570W	27	522MHz	31	554MHz
37	BERAT	AL008D-033	KOSHINICA (Mendrakë)	40°47'19"	20°05'39.4"	949	570W	25	506MHz	30	546MHz
38	BERAT	AL008D-021	GLLAVA	40°29'24.7"	19°59'02.6"	1168	1100W	25	506MHz	30	546MHz

39	BERAT	AL008D-020	BERAT KALA(Berat X)	40°42'54.9"	19°53'28.4"	614	570W	25	506MHz	30	546MHz
40	BERAT	AL008D-049	BOGOVA	40°32'28.2"	20°06'27"	643	570W	25	506MHz	30	546MHz
41	BERAT	AL008D-050	POLICANI	40°35'20.4"	20°04'25.8"	641	50W	25	506MHz	30	546MHz
42	BERAT	AL008D-022	COROVODA	40°30'45.1"	20°13'07.3"	568	50W	25	506MHz	30	546MHz
43	KORCE	AL009D-023	MORAVE(CARDHAK)	40°36'46"	20°50'53.9"	1812	570W	43	650MHz	45	666MHz
44	KORCE	AL009D-024	PEPELLASH	40°28'40.4"	20°41'42.2"	1388	570W	43	650MHz	45	666MHz
45	KORCE	AL009D-051	TUSHEMISHTI	40°54'04.4"	20°44'00.9"	964	570W	43	650MHz	45	666MHz
46	KORCE	AL009D-052	LESKOVIKU	40°09'44.7"	20°36'21"	1208	50W	43	650MHz	45	666MHz
47	GJIROKASTER	AL011D-055	SOPOTI	39°59'48.3"	20°07'24.4"	1589	1100W	26	514MHz	37	602MHz
48	GJIROKASTER	AL010D-026	ASIM ZENELI(Kerculle)	40°06'05.3"	20°09'43.7"	392	570W	26	514MHz	37	602MHz
49	GJIROKASTER	AL010D-025	PERMETI	40°13'02"	20°23'45.3"	457	570W	26	514MHz	37	602MHz
50	GJIROKASTER	AL010D-053	TEPELENA	40°18'30.9"	20°01'55"	337	570W	26	514MHz	37	602MHz
51	GJIROKASTER	AL010D-054	CARSHOVA	40°07'03.2"	20°33'27.1"	872	50W	26	514MHz	37	602MHz
52	VLORE	AL011D-055	SOPOTI	39°59'48.3"	20°07'24.4"	1589	1100W	23	490MHz	39	618MHz
53	VLORE	AL011D-056	SHASHICA	40°24'59.8"	19°30'48.8"	732	570W	23	490MHz	39	618MHz
54	VLORE	AL011D-057	TREBLOVA	40°29'4.60"	19°38'47.70"	508	570W	23	490MHz	39	618MHz
55	VLORE	AL011D-028	LLOGORA	40°11'55.8"	19°34'25.4"	1345	1100W	23	490MHz	39	618MHz
56	VLORE	AL011D-058	SHEN VASILI	39°56'52.4"	19°57'26.6"	786	570W	23	490MHz	39	618MHz
57	VLORE	AL011D-029	MILE	39°45'16.7"	20°05'27.3"	805	1100W	23	490MHz	39	618MHz
58	VLORE	AL011D-027	ZVERNECI	40°30'32.8"	19°25'08.4"	77	1100W	23	490MHz	39	618MHz
59	VLORE	AL011D-059	KSAMILI	39°45'24.7"	19°59'14.9"	135	50W	23	490MHz	39	618MHz